

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK**



**LËNDA:
MIKROEKONOMIA**

Asistent: Msc. Neshat PODVORICA
E-mail: neshat.podvorica@uni-pr.edu
Tel: 044 400 326
Orari i U: E Hënë 08:00 - 09:30 (S9); Konsultime: Kabineti 89
E Marte 11:30–13:00 (S6)
Tetor, 2019

SILABUSI

- E gjeni në faqen e Fakultetit Ekonomik
- E keni diskutu me profesorin ose do e diskutoni
- Pjesëmarrja në ushtrime dhe benefitet
 - Përgatitja për kollokfiume
 - Përqindje e caktuar e pikëve që fitoni nga aktivitetet në ushtrime

Çka studiojnë ekonomistët?

- Problemet ekonomike
 - Prodhimin dhe konsumin
- Pamjaftueshmëria: problemi kryesor ekonomik
 - Definimi i pamjaftueshmërisë
 - Faktorët e prodhimit
 - Puna
 - Toka
 - Kapitali
 - Kërkesa dhe oferta

Çka studiojnë ekonomistët?

- Qështjet makroekonomike
 - Rritja ekonomike;
 - Papunësia;
 - Inflacioni;
 - Bilancin e pagesave;
 - Luhatjet ciklike të ekonomisë.

Çka studiojnë ekonomistët?

- Qështjet mikroekonomike
 - zgjedhjet: çka, si dhe për kënd
 - Konceptin e kostove oportune
 - Marrjen e vendimeve racionale ekonomike
 - Kostot marginale dhe të ardhurat marginale
 - Objektivat mikroekonomike
 - Efiqienca
 - Kapitali
 - Definimin e kufirit të mundësive të prodhimit

Pra cili është dallimi në mes të mikroekonomisë dhe makroekonomisë?

Çka studion ekonomia?

- Sjelljen e agjentëve ekonomik në shoqëri dhe kushtet ekonomike në të cilat bashkëveprojnë
- **Cilët janë agjentët ekonomik?**
 1. Individët (familja);
 2. Firmat;
 3. Qeveria;
 - **Firmë** quajmë cdo organizatë që prodhon mallra dhe shërbime.

Pse studiohet ekonomia?

- Ekonomia studiohet për të arritur një pasuri dhe një mirëqenie të përgjithshme.
- **Pasuria** – paraqet stokun e mallrave e shërbimeve të një vendi;
- **Mirëqenia**- kënaqësin që e përjetojn njerëzit, dhe shprehet përmes **efiqencës** dhe **drejtësisë**.
- **Faktorët e prodhimit**: Puna, toka, kapitali,(aftësia sipërmarrëse dhe teknologjia)


Pse studiohet ekonomia?

- Thelbi se pse studiohet ekonomia është: **Pamjaftueshmëria** (rrallësia).
- Sepse burimet e kufizuara ndërsa nevojat e pakufizuara.
- Problemet ekonomike lidhen me tre pyetje:
 1. Çfarë të prodhohet;
 2. Si të prodhohet;
 3. Për kë të prodhohet.

Kufiri i mundësive të prodhimit

Shpreh kombinime të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve që mund të prodhojë një vend gjatë një periudhe të dhënë kohe, duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion dhe me teknikat më efikënte të prodhimit.

Kufiri i mundësive të prodhimit



Kostoja oportune (alternative)

- Paraqet sasinë e produkteve të cilat nuk e kemi marrë, sepse kemi zgjedhur një produkt tjetër për ta marrë.
- **K.O.** është e lidhur drejtpërdrejt me kufirin e mundësive të prodhimit.
- Të punojmë apo të vazhdojmë studimet?
- **Kosto op. rritëse**- për të prodhuar një njësi të një produkti duhet hjekur dorë më shumë nga një produkt tjetër.


Llojet e efqencës

- **Efiquenca**- ka të bëjë me nxjerrjen e dobisë maksimale duke shfrytëzuar burimet që ka.
- **E. ekonomike**- ajo gjendje ku nuk mund të rritet mirëqenia e ndokujtë pa u zvogëluar e dikujt tjetër;
- **E. prodhuese** - prodhimin e sa më shumë produkteve me inpute më të vogla (Produktiviteti)
- **E. alokative** - burimet të orientohen në prodhimin e asaj që kërkon shoqëria;
- **E. në shpërndarje**- të jetë shpërndarje ku qytetarët nuk do të bënin zgjedhje tjetër.


Ekonomitë e hapura dhe të mbyllura

- **E. e mbyllura** – konsumojnë veq sa prodhojnë.
- **E. e hapura** – mund të konsumojnë sa prodhojnë, por edhe sa kanë transaksione me vendet tjera.
- Ekonomitë mikse
- **Cilën llojë të ekonomisë e preferoni ju?**
- **Qeveria ndërhy:** rritjen e efqencës, sigurimin e drejtësisë dhe stabilizimin e ekonomisë.

Klasifikimi i sistemeve ekonomike



Klasifikimi i sistemeve ekonomike



Avantazhet krahasuese

- Nëse një produkt e prodhon me kosto më të ulët se të tjerët.
- Apo, nëse një produkt e prodhon me kosto oportune më të ulët.
- **Norma marxhinale e transformimit (MRT)** – tregon se për të prodhuar një njësi shtesë të produktit sa duhet hjekur dorë prej produktit tjetër.

Qeveria ndjek tre parime bazë



1. Rritjen e efqiencies;
2. Sigurimin e drejtësisë;
3. Stabilizimin e ekonomisë

Pohimet pozitive dhe pohimet normative

P. Pozitive – kanë të bëjnë me përshkrimin dhe shpjegimin e dukurive ekonomike. Çfarë ishte, çfarë është, çdo të jetë?

Pohimet normative - japin sugjerime si duhet të jetë. Papunësia në Kosovë duhet të ulet.

Metodologjia e ekonomisë

- **Deduksioni**– fillon nga hipoteza të përgjithshme për të dalur tek ato të veçanta
 - E përgjithshmja  individualës
 - Shembull: _____
- **Induksioni**- fillon nga mbledhja e të dhënave dhe jep hipoteza të caktuara.
 - Individualja  E përgjithshmes
 - Shembull: _____

Ju faleminderit!!!